

Gjyqtar Luan Daci

Z. Daci, i lindur në Tepelenë, në vitin 1957, fitoi titullin “jurist” pas diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës, në vitin 1994. Në vitin 2008, z. Daci fitoi titullin “master shkencor” në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës.

Z. Daci ka ushtruar funksionin e ndihmësgjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga shtatori i vitit 1993 deri në mars të vitit 1994, ndërsa nga marsi i vitit 1994 deri në dhjetor të vitit 1997, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë kësaj gjykate.

Pasi fitoi titullin “avokat”, z. Daci ushtroi këtë profesion në të gjitha shkallët e gjykimit dhe procedimeve, për një periudhë të gjatë kohore prej 17 vitesh, prej vitit 2000 deri në vitin 2017, me një eksperiencë që vlen të theksohet.

Me vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, z. Daci u zgjodh gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, funksion të cilin e ushtron prej qershorit 2017 e në vazhdim.